

# Rrëqebulli, "Luani i Ballkanit", një ndër pasuritë e paçmuara të Tomorrit, drejt zhdukjes

Olsi Qazimi (PPNEA)

Aleksandër Trajçe (PPNEA)



Tomori është mali më i adhuruar nga njerëzit e më i mrekullueshmi në të gjithë Shqipërinë. Ky mal i shenjtë e i drejtë ka mbartur mbi vete gjoiëdhëna e legjenda

kafshë misterioze, "Luani i Ballkanit", siç thirret ndryshe, rrëqebulli. I fshehur ndër pyjet e pashkelura nga njeriu, i pajisur me aftesi të jashtëzakonshme eluzive e për të gjuajtur, një kafshë nocturne, gjithmonë i vetëm (rrëqebulli shihet i shoqëruar vetëm me të voglin e saj në vitin e parë të jetës dhe në muajin e çiftimit), rrallë është parë nga njeriu.

Rrëqebulli është mishngrënësi i tretë më i madh në Evropë pas ariut dhe ujkut. Kjo kafshë mbresëlënëse nuk nuk armiq

aty? Çfarë ka ndodhur me këtë mace që përmadheshtinë e saj, e mbiquajtëm "Luani i Ballkanit"?

Zhudja ose jo e rrëqebullit është e lidhur ngushtë me shkatërrimin e habitatit të tij, pyllin, dhe me gjuetinë e paligjshme dhe pa kriter që zhvillohet në malin e shenjtë. Jo vetëm rrëqebulli, por e gjithë fauna e Tomorrit është në rrezik.

Vite përpëra, në 1905-1939, shqiptarët shoqëronin gjuetarët italianë që gujanin në

PROJEKTI PËR RUAJTJEN DHE MONITORIMIN  
E RRËQESELLIT TË BALLKANIT

**RRËQESELLI**  
**MACE E MADHE ME**  
**MUNDËSI TË VOGLA**



[www.mes.org.mk](http://www.mes.org.mk)

DREJTOR:  
**Xhevahir SPAHIU**

KRYEREDAKTOR:  
**Zylyftar HOXHA**

## KËSHILLI BOTUES:

Bahri Myftari  
Visar Zhiti  
Pandeli Çina  
Arian Leka  
Hysen Kordha  
Pano Taçi  
Nuri Çuni  
Izet Dyrmishi  
Haxhi Kalluci  
Rushan Dosti  
Luan Dyrmishi  
Fatos Ylli  
Hajri Nuhu  
Vetëtim Bejko

Adresa:  
Kafe "Europa"  
Tiranë,  
Shqipëri

Nr. tel: **4274438**  
Nr. tel: **04272815**  
cel: **0682565709**

inresi dhe ligesi, mistere e mite, të shenjtë e martirë dhe prapë nuk lodhet, por është aty duke mos u kursyer për askënd me bukuritë e tij përrallore dhe begatinë e tij të pafund. Natyra piktoreske e Tomorrit është përmendur gjithmonë për faunën dhe florën e larmishme. Naim Frashëri, Çajupi dhe rilindës të tjerë i kënduan shenjtërisë së malit të Tomorrit, e quajtën atë simbol të bashkimit të shqiptarëve, Babamal të Shqipërisë. Ndërsa

Për të treguar nevojën e bashkimit të shqiptarëve, për të dëshmuar vlerat e gjuhës shqipe, por edhe për të evidentuar pasuritë dhe begatitë e natyrës shqiptare, Konstantin Kristoforidhi, një ndër rilindësit e hershëm, subjektin e veprës së tij brilante "Gjahu i malësorëve" e vendos në Tomorr. Nga ana tjeter, Eqrem bej Vlora, një nga realistët më të famshëm shqiptarë, ka ndërmarrë një sërë udhëtimesh dhe ekspeditash në Tomorr, vetëm e vetëm që të kishte mundësinë të sodiste kafshët e shumta të tij. Antonio Baldaçi, botanisti i shquar italian, krahas shënimave e studimeve të tjera në Shqipëri, në vitin 1927 zbuloi në Tomorr një nga bimët më të rralla dhe të pa njoitura deri në atë kohë, zambakun e Tomorrit, që ka marrë emrin shkencor të njojur në të gjithë botën, Nepenthis Tomoriana. Pikërisht për këto, por dhe për shumë vlera të tjera, Tomori është shpallur i pari Park Kombëtar dhe kësisoj e para Zonë e Mbrojtur në Shqipëri, qysh në vitin 1940.

A e dini se në pyjet e thella e të dendura të Tomorrit gjithmonë është endur një

natyrorë edhe pse në Tomorr ka arinj dbe ujq. Rrëqebulli ka ecur gjithmonë i qetë në mbretërinë e tij, pyllin. Po sot, a është më



nëjëja situatë është edhe sot, por gjuetarëve italianë u janë shtuar edhe ata shqiptarë, duke e cuar kështu drejt fundit mbijetesën e kafshëve të egra në Tomorr. Për ta vërtetuar këtë situatë, ekipi për Shpëtimin e Rrëqebullit të Ballkanit" në Shqipëri (Albanian Lynx Group) ndërmori një ekspeditë në malin e Tomorrit. Nga ekspedita, ku përfshiheshin vlerësimi i habitatit dhe intervista me banorë të zonës, rezultoi se rasti i fundit i vrasjes së rrëqebullit i përkiste tre viteve përpara, kurse ariu ishte vetëm 2 muaj përpara. Situata paraqitet tepër serioze për një zonë të mbrojtur siç është mal i Tomorrit. Po sikur rrëqebulli i vrarë të ishte individi i fundit në malin e Tomorrit? Kjo do të thotë zhdukjen njëherë e përgjithmonë të këtij mishngrënësi nga kjo zonë. Duhet theksuar se popullata e rrëqebullit në Shqipëri nuk i kalon 25 individë. Gjeneticienë nga Zvicra e kanë parapërcaktuar rrëqebullin e Ballkanit si subspecie më vete, kurse statusi i tij në Shqipëri është "Në rrezik zhdukje". Duhet bërë çfarë është e mundur që nëse rrëqebulli mbijeton akoma, ta mbrojmë dhe nëse është zhdukur, ta rikthejmë.

Kjo pasuri i përket malit të Tomorrit dhe të gjithë Shqipërisë dhe detyra jonë është t'i japim fund një herë e përgjithmonë masakrës së faunës në Malin e shenjtë të Tomorrit, fronin e perëndive, strehën e ëmbël e të përhershme të kafshëve aq të dobishme për njeriun dhe natyrën shqiptare.